



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

---

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 40, pika 40.2, shkronja a të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane dhe të dispozitave të nenit 34, pika 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më \_\_\_\_\_, miratoi këtë

**PROJEKTRREGULLORE**  
**PËR**  
**NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE**  
**BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET**  
**URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**NR. 01-030/01-0134831/18 e dt. 06.06.2018**

**Neni I**

Ndryshohet dhe riformulohet neni 4, paragrafi 4.1 i rregullores bazike me tekstin si në vijim:

4.1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për te udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë 7 anëtarë, katër (4) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjekte të ndryshme politike, një (1) anëtar nga ekzekutivi, një (1) anëtar nga shoqëria civile dhe një (1) përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal.  
Nga 7 anëtarët e komisionit 3 (tre) duhet të jenë femra, si dhe 1 anëtar ose anëtare patjetër të jetë e komunitetit jo shumicë. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësoj përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.  
Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e komisionit.

**Neni II**

Ndryshohet dhe riformulohet neni 5, paragrafët 5.12 dhe 5.13 të Rregullores bazike me tekstin si në vijim:

5.12. Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, zgjedhen me mandat 4 vjeçar.

5.13. Tubimet e kanë legjitimitetin juridik, nëse në tubime janë të pranishëm së paku 20 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti. Përfaqësimi në këshillat lokal duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor dhe etnik.

### **Neni III**

Ndryshohet dhe riformulohet neni 13 i Rregullores me tekstin dhe paragrafët e ri si në vijim:

13.1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës përkatëse.

13.2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokal bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative.

13.3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.

### **Neni IV**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtorja e Administratës dhe drejtoritë e tjera relevante.

### **Neni V**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Fehmi Kupina**